

Enthemima

Fjala ‘enthemimë’ vjen prej grc. ἐνθύμημα enthýmēma. Ajo është një silogjizëm / argument formal i cinguom të cilit i mungon njëna prej dy primisave ose, ma rrallë, përfundimi. Në diskurse të sinqerta, pjesa që mungon nënkuptohet prej autorit edhe audiencës. Kjo i jep audiencës njëfarë fuqie sepse ajo e ban diskursin më ndërveprues. Kur diskursi është i pasinqertë, propozimi që mungon mund të përdoret me manipulua audiencën.

Sëbashku me pjesën e nënkuptuome, enthemima ka trí propozime—dy premisa dhe një përfundim—prandaj ajo mund të kthehet në silogjizëm, dhe kështu mund të hulumtohet vertetsia e taj.

Enthemima është argumenti bazë i retorikës, *disiplinës së artit të bindjes*. Argumentet enthemimike mund të jenë të shëndosha, por edhe vetëm mund të duken si të tilla. Audiencia mund ta kuptojë propozimin që mungon, por edhe mund të mos e kuptojë. Në lanjen jashtë të propozimit, retori mund të jetë i sinqertë por edhe dredhtar; cingimi formal nuk duhet të kthehet në cingim logjik.

Enthemima është pjesë e retorikës, e cila cakon me bindë një masë njerëzish, prandaj ajo duhet të jetë e thjeshtë, e shkurtë, dhe praktike.

Edhe sikur Retori (enthemimisti), të kishte ekspertizën ose pëvojën e duhun, ai nuk do të kishte kohë t’i mësonte audiencës së tij artin e argumentimit (dialektikën) ose logjikën formale (silogjizmin). Prandaj, atij i duhet të bazohet në bindjet relativisht të pranuome prej një pjese të popullsisë (endoksa).

Farët e enthemimës

Enthemima mbështetet në opinione të formuome a idé të pranuome prej masave, prandaj ajo ka natyrë deduktive; domethanë ajo nisë prej të përgjithëshmes dhe sosë në të veçantën. Kjo ndryshon prej arsytimit induktiv, ku nisët prej të veçantës dhe sosët në të përgjithëshmen.

Me gjetë se cili propozim (premisat ose përfundimi) mungon në enthemimë, ajo duhet vendosun në një argument formal (silogjizëm). Sipas propozimit që mungon, enthemimat mund të ndahen në trí kategori.

1. Mungon premisa e madhe

Enthemimë: *Sokrati është vdektar sepse ai është njeri.*

Silogjizëm:

PM. *Tan njerëzit janë vdektarë.* (mungon në enthemimë)

PV. *Sokrati është njeri.*

Pf. *Prandaj, Sokrati është vdektar.*

Duke besua që ai dhe audienca pajtohen me premisën e madhe, autori e len atë që të nënkuptohet.

2. Mungon premisa e vogël

Enthemimë: *Tan njerëzit janë vdektarë, prandaj Sokrati është vdektar.*

Silogjizëm:

PM. *Tan njerëzit janë vdektarë.*

PV. *Sokrati është njeri.* (mungon në enthemimë)

P. *Prandaj, Sokrati është vdektar.*

I njëjëti parim si në 1. më nëlt; informacioni që dihet nuk përsëritet.

3. Mungesa e përfundimit

Enthemimë: *Sokrati është vdektar.*

Silogjizëm:

PM. *Tan njerëzit janë vdektarë.*

PV. *Sokrati është njeri.*

P. *Prandaj, Sokrati është vdektar.* (mungon në enthemimë)

Enthemimat ku mungon përfundimi janë të rralla, sepse ato nuk tinglojnë krejt drejt.

Përdorimi i enthemimës

1. Sinjalizimi i enthemimës mund të tregohet prej disa fjalësh tipike:

edhe, ose = Sinjalizojnë lidhjen e dy premisave, dhe se përfundimi mungon.

sepse = Sinjalizon një premisë të pasuome prej një tjetre; premisa që pason mund të funksionojë edhe si përfundim.

prandaj = Sinjalizon përfundimin e argumentit.

2. Në bisedat e përditëshme, shumica a folësve përdorin enthemima në vend të argumenteve formale; jo aq prej mungesës së ekspertizës sesa prej nevojës me shmangë përsëritjet e panevojëshme.

3. Politikanët, avoketënit, shitësit, dhe influencues të tjerë i japin retorikës në përgjithsi dhe enthemimës në veçantí emën të keq; sikur ato të ishin një set-almishesh (tool-set)

mashtuese, manipuluese, e shfrytzuere. Tipikisht, dobsia enthemimike që këta persona shfrytzojnë është propozimi që mungon, i cili mund të lehet jashtë veçsisht kur audienca është e pastërvitun në të kuptuomit e argumenteve.

4. Përdorri i enthemimave nuk mund të shuhet sepse ato dalin edhe në shprehje popullore, klishé, aforizma, maksima, fjalë të urta, e të tjera, p.sh.,

Kij besim në vetvete se të del mirë.

Silogjizëm:

Të gjithë njerëzve që kanë besim në vetvete u del mirë.

Ti je njeri.

Prandaj, edhe ti, po pate besim në vetvete ka me të dalë mirë.

Krahasimi i enthemimës me silogjizmin

Një ndryshim thalbsor në mes silogjizmit dhe enthemimës është situata ku aplikohet secila sosh. Silogjizmi mund të ndërtohet prej një mendimtari (logjicisti) të vetëm, kurse enthemima kërkon që retorikë të flasi para një audience, shpesh një audience të pastërvitun në artin e argumentimit. Ndërsa argumenti i silogjizmit gjykohet prej ekspertëve, argumenti i retorikës gjykohet prej njerëzve të randodmtë; votuesve, blesëve, spektatorëve, teleshikuesve, e të tjerë.

Silogjizmi ka tri aserta ose propozime: Premisën e Madhe (PM), Premisën e Vogël (PV) dhe Përfundimin (Pf), kurse Enthemima ka dy sosh. Në bisedat e përditëshme, ku njerëzit marrin informacione prej të njëjësive burime dhe prej përvojash të përafërta, shumë silogjizma shprehen si enthemima sepse propozimi që mungon pranohet prej palëve ndërkumtuese. Por kur mungesa e një propozimi përdoret me caqe retorike, kjo mungesë mund të fshehet qëllimisht sepse, p.sh.,

- propozimi i nënkuptuom mund të nxisi njëfarë ndërkumtimi në mes të autorit dhe audiencës
- qitja në pah e propozimit të nënkuptuom mund të qesi në pah se enthemima bazohet në një argument të palvertë.